



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
DREJTORIA E EDUKIMIT PER CIKLIN I DHE II TE STUDIMEVE**

NJOFTIM

PËR PARAQITJEN E APLIKIMEVE PËR TË PËRFITUAR MBËSHTETJE FINANCIARE, NGA STUDENTËT E REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2024-2025

Në zbatim të VKM me Nr. 386 dt. 01.06.2022 "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të sudentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.397 dt.29.06.2023 dhe VKM nr. 448, datë 03.07.2024, njoftojme si më poshtë:

Të gjithë studentët shtetas shqiptarë, të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë, për program të parë studimi mund të aplikojnë për të përfitur mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, nëse plotësojnë kriteret, si më poshtë:

A. Studentët e shkëlqyer:

Studentët me notë mesatare në pranim, që:

- Kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00;
- Në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore janë vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5 deri në 10.00.

B. Studentët fitues të olimpiadave:

- Studentet fitues të njërit prej tri çmimeve të para, në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohen në programe studimi, që lidhen me lëndën/disiplinën ku kanë fituar çmimin.

C. Studentët në programe prioritare:

- Studentët që kanë zgjedhur të ndjekin një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, të përcaktuar në Vendimin nr.386 datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave(i ndryshuar) .

Aplikimet dorëzohen pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), në rrugë postare ose dorazi në adresën : Rruga " Naim Frashëri ", nr.37, Tiranë,

Periudha e aplikimit 15 Tetor - 15 Dhjetor 2024.

Shkarko Formularin e Aplikimit [Këtu](#)